

**V E N D I M**  
**Nr.402, datë 1.8.1994**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.301, DATË 14.6.1993 “PËR MASAT PËR ZBATIMIN E LIGJIT “PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE ISH-PRONARËVE”**

Me propozimin e Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Ish-Pronarëve, Këshilli i Ministrave,

**V E N D O S I :**

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.301, datë 14.6.1993 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

- Shkronja “a” ndryshohet si vijon: “Evidencon pretendimet e ish-pronarit dhe të komisioneve për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve për probleme që nuk kanë gjetur zgjidhje në ligj”.

- Shkronja “ç” ndryshohet si vijon: “Jep përgjigje dhe u bën sqarimet përkatëse personave të interesuar për problemet që përmban ligji”.

Komiteti zhvillon veprimtarinë e tij pranë Këshillit të Ministrave. Për kryerjen e veprimtarisë së tij organizative dhe administrative, punojnë me shkëputje nga puna 7 (shtatë) veta.

Pagat e punonjësve të jenë sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1993 “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, lidhja II-4/7 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.393, datë 3.9.1992, në lidhjen nr.1, në pikën 6, shtohet emërtimi: “Kryetari i Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Ish-Pronarëve”, në pikën 7 shtohet emërtimi: “Zëvendëskryetar i Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Ish-Pronarëve” dhe në pikën 11 shtohet emërtimi: “Këshilltar i kryetarit të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Ish-Pronarëve”.

Emërimi i kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Ish-Pronarëve bëhet nga Këshilli i Ministrave dhe për funksionet e tjera të kësaj strukture organizative me shkëputje nga puna emërimi bëhet nga kryetari i këtij Komiteti”.

2. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime:

- Në shkronjën “a” paragrafi i 8-të ndryshohet si vijon: “Evidencojnë pretendimet e ish-pronarëve që nuk kanë gjetur zgjidhje në ligj dhe ia paraqesin Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Ish-Pronarëve.

Për afatet e shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura nga ish-pronarët, marrjen e vendimeve, dërgim të dhënash mbi bazën e kërkesës së Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Ish-Pronarëve, ky i fundit nxjerr udhëzime të veçanta që janë të detyrueshëm për zbatim nga komisionet e kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve në rrethe dhe bashki.

Kryetari i Komitetit Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Ish-pronarëve i propozon organeve përkatëse masa disiplinore e administrative për personat përgjegjës për moskryerjen e detyrave të caktuara nga komisionet”.

- Në shkronjën “b” paragrafi i parafundit ndryshohet si vijon:

“Në komision të jenë me shkëputje nga puna deri në fund të vitit 1995, 3 veta, nënkryetari, ekonomisti ose juristi dhe arkivist-sekretar-daktilografist”.

- Në shkronjën “c” në pikat 1 dhe 2, masa e shpërblimit plotësues mujor prej 2200 lekë të zëvendësohet me shpërblimin plotësues mujor 60 për qind të pagës bazë sipas funksionit të secilit anëtar por jo më shumë se 4000 lekë”.

3. Ngarkohet aparati i Këshillit të Ministrave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare për pagat nga data e caktimit në detyrë të punonjësve të Komitetit nga organi i emërtesës.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE**  
**Aleksandër Meksi**

